



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:268404

Datë: 13.08.2024

Numri i dokumentit: 06045396

C.nr.1754/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Blerim Istrefi dhe me bashkëpunëtoren profesionale F.A-XH, në çështjen juridike të paditësit: Z.S nga M... V..., të cilin sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson Festim Shala, av me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-P...K..., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore. Baza juridike e kontestit “Kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës”, vlera e kontestit 1,861.65 euro, jashtë seancës gjyqësore konform nenit 398 dhe 399 të LPK-së, me datë 13.08.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z.S nga M... V..., ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-P...K..., që paditësit në emër të kompensimit të pagës së fund vitit (paga e trembëdhjetë) për vitin 2018,2019, dhe 2020, t’ia paguaje shumën 1,595.70 euro (njëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pese euro e shtatëdhjetë cent), si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës 50% të pagës bazë shumën prej 161.95 euro (njëqind e gjashtëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë e pese cent), apo shumën e përgjithshme të detyrimit prej 1757.65 euro, me kamat ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të paditës në gjykatë (datë 30.11.2021), të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.
- II. **REFUZOHET PJESËRISHT** si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Z.S nga M... V... për kompensimin e 50% të pagës bazë për 20 vite të përvojës së punës në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej 104.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 30.11.2021, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej njëzetë 134.00 euro (njëqind e katër euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Z.S., nëpërmes të autorizuarit të tij, më datë 30.11.2021 ka ushtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-P...K..., e me të cilin ka kërkuar kompensimin në emër të pagës së fund vitit edhe atë për vitin 2018,2019 dhe 2020 si dhe kompensimin e 50% të pagës baze për 20 vite të përvojës së punës në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej 265.95

euro, me kamat ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Sipas përshkrimit në padi, paditësi nuk i është paguar paga e fund vitit përkatësisht paga e 13 edhe atë për vitin 2018,2019 dhe 2020 edhe pse ka qenë e përcaktuar me udhëzimin administrativ numër 02/2018, për shkak të mos realizimit të këtij kompensimi, paditësi ju ka drejtuar edhe me shkrim të paditurës. Po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 104 euro në emër te përpilimit te padisë dhe 30 euro në emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata, me Aktvendimin C.nr.1754/2021 të datës 19.04.2024, e ka detyruar të paditurin që brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të paraqet përgjigje në padinë e paditësit nën paralajmërimin për pasojat procedurale nëse nuk veprohet konform këtij Aktvendimi, dhe ndër të tjera i padituri është paralajmëruar se gjykata do të marr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë apo mosbindjes nëse nuk e paraqet përgjigjen në padi brenda afatit të përcaktuar.

E paditura, më datë 08.05.2024 ka paraqitur përgjigjen në padi, ku ka deklaruar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, mirëpo kërkesa e paditësit sa i përket kompensimit të pagës së 13, e kundërshtojnë pasi qe është kërkesë e parashkruar ndërsa sa i përket kërkesës për kompensimin e shpërblimit jubilar ka njoftuar se e paditura në muajin Shtator të vitit 2022 i'ka paguar shumën prej 104.00 euro dhe për këtë ka bashkangjitur listën e pagës, andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pathemeltë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pjesërisht, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga kërkesa e datës 19.10.2021 vërtetohet fakti se paditësi i është drejtuar te paditurës për kompensimin e pagës se 13 për vitet e cekura ne piken I te dispozitiv te këtij aktgjykimi si dhe kompensimin ne emër te shpërblimit jubilar.

Ndërsa nga provat e dorëzuara me padi të lëshuara nga vet e paditura si: Vërtetimi me numër të protokollit 04/1-7-SRR-670/2021 i datës 31.08.2021, gjykata ka konstatuar se këtu paditësit është i punësuar me orar të plotë tek e paditura- P...K..., që nga data 23.09.2002, në pozitën Polic PK5714 dhe realizon page mujore në lartësi prej 531.90 euro për një muaj kalendarik.

Nga leximi i Formularëve për vlerësimin e performancës të përpiluara nga e paditura, gjykata ka konstatuar se paditësi gjatë këtyre viteve ka treguar performancë të kënaqshme të punës, si kriter bazë për përfitimin e shpërblimit prej një page mujore shtesë në fund vitit (apo paga e trembëdhjetë).

Gjykata, pasi ka vërtetuar në mënyrë të padyshimtë gjendjen faktike nga provat e ofruara nga ana e paditësit, ka obliguar të paditurin që pjesërisht si në piken I te dispozitivit të këtij Aktgjykimi, po ashtu është vërtetuar pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt se paditësi ka të drejtë në pagesën e kompensimit të një page shtesë në fund vit (paga e trembëdhjetë) dhe kjo e drejtë fillimisht bazohet në nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 (këtu e tutje LP) ku përcaktohet se “I punësuar i ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”.

Se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar konstatohet edhe në bazë të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, i cili është ligj special në rastin e marrëdhënies së punës për paditësit, ku në nenin 44 paragrafi 2 përcaktohet se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me

akt nënligjor”. Ndërsa neni 55 paragrafi 1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punë”, siç përshkruhet në paragrafin 2 të nenit 44 të këtij ligji. Dhe përfundimisht kërkesëpadia e paditësve pjesërisht bazohet në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, ku përcaktohet se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”, pasi që paditësit gjatë periudhës 2018,2019 dhe 2020 ka pasur vlerësim të maksimal në punë dhe nuk ka qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore.

Tutje, neni 245 të LMD ka paraparë se “kreditoret në marrëdhëniet detyimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj Gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Ndërsa sa i përket pretendimit të paditurës kërkesa e paditësit është e parashkruar, për gjykatën ky pretendim ishte në tërësi i pa bazuar pasi që paditësi ka paraqitur padinë me datën 30.11.2021 dhe ka kërkuar kompensimin në emër e pagave të 13 paga vitit 2018, 2019 dhe 2020, andaj të njëjtit i takojnë pasi që nuk kanë kaluar tri vite nga dita kur paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë realizimin e kërkesave të tij e deri në vitin kur paditësi ka kërkuar nga e paditura me kërkesën e datës 19.10.2021, ndërsa sa i përket pretendimit të paditësit i është paguar shpërblimi jubilar për gjykatën ky pretendim i të paditurës qëndron pjesërisht pasi që nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësit i janë paguar 104.00 euro në emër të shpërblimit jubilar, por jo shumat e tërësishme që i ka takuar të njëjtit pasi që në bazë të Udhëzimit Administrativ përcaktohet se me rastin e shpërblimit jubilar punëdhënësit i takon 50% e pagës bazë, meqenëse paditësi ka realizuar pagë në lartësi 531.90, të njëjtit i takon shumat prej 265.95 euro, mirëpo meqenëse i është paguar shumat prej 104euro gjykata ka obliguar paditësen që të paguaj pjesën tjetër në shumën prej 161.95 euro.

Gjykata në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka vendosur që të refuzoj pjesërisht kërkesën e paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar pasi që i njëjti me parashtresën e datës 04.03.2024 ka kërkuar shumën prej 265.95 euro apo 50% të pagës bazë për 20 vite përvojë pune, mirëpo të njëjtit i është paguar shumat prej 104.00 euro nga ana e të paditurës, andaj gjykata i ka njohur vetëm shumën prej 161.95, të cekur në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK, e cila dispozitë përcakton “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Ndërsa, me nenin 4 paragrafi 2 i të njëjtit ligj përcaktohet se: “Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”, e në lidhje me nenin 399 të LPK-së ku përcaktohet se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.

Lidhur më kamatën ligjorë të kërkuar nga paditësi, duke qenë se e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit padisë në gjykatë (30.11.2021), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur nga paraqitja e padisë është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 dhe nenit 453 paragrafi 1 dhe 2 të LPK, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t'ia kompensojë shpenzimet gjyqësore, Gjykata ka marrë për bazë vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, kjo sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej 104 euro dhe taksës gjyqësore shumë prej 30 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme 134 Euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1754/2021, datë 13.08.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.